

**Miratohet
Petrit Vasili
Kryetari i KMR
Minister i Shendetesise**

**STATUSI I FIZIKANIT MJEKESOR NE
SHQIPERI**

Nr.459/1 prot

Date . 31.01.2012

Permbajtja

- | | |
|--|------------------------------|
| 1. Hyrje..... | 3 |
| 2. Statusi Fizikanit dhe Edukimi ne Europe..... | Error! Bookmark not defined. |
| 3. Rekomandimet IAEA EFOMP | 5 |
| 4. Statusi i Fizikanit Mjekesor ne Shqiperi | 6 |

Sqarim paraprak

Ky material permban informacione per rekomandimet e dhena nga institucionet nderkombetare per Statusin e fizikanit Mjekesor, njohjen dhe certifikimin e ketij statusi si nje profesion ne fushen e sherbimit shendetesor si dhe propozime per matjen e statusit te Fizikanit Mjekesor ne Shqiperi.

Rekomandimet dhe nje pjese e materialeve te perdorura jane marre nga faqet zyrtare te Agjensise Nderkombetare te Energjise Atomike IAEA,Komisionit European (EC)si dhe Federates Europiane te Organizatave te Fizikaneve Mjekesore(EFOMP), .

1. Hyrje

Fizika Mjekesore eshte dega e fizikes qe kryen aplikimin e koncepteve ligjeve modeleve dhe metodologjive te caktuara te fizikes ne parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e semundjeve, duke kryer nje funksion ne ndihme te mjekesise, ne investigimin e biomjekesise dhe ne optimizimin e disa aktiviteteve sanitare

Aktualisht Fizika Mjekesore administron bazat fizike te shume teknikave terapeutike, porpcionon bazen shkencore per kuptimin dhe zhvillimin e teknologjive moderne qe kane revolucionuar mjekesine e diagnostikes dhe vendos kriteret per perdonimin korrekt te agjenteve fizike te implikuar ne Mjekesi.

Qe nga fillimet e shekullit te kaluar aplikimet e Fizikes ne Mjekesi jane rritur ne menyre progresive. Njesi te reja trajtimi (njesi te kobalto-terapise, pershpejtues elektronesh, etj) dhe te diagnostikes (gamakamera, tomografi e emetimit te positroneve PET, radiologji dixhitale, rezonance magnetike etj) kane kerkuar rritjen e numrit te fizikaneve ne spitalet e gjithe botes.

Ne shume vende si rrjedhoje e ketij fenomeni eshte ndjere e nevojshme nxjerja e ligjeve dhe rregullave qe krijojne dhe rregullojne marjen e statusit zyrtar te profesionit te Fizikanit Mjekesor si specialitet i vecante ne fushen e sherbimit shendetesor.

2. Statusi i Fizikanit Mjekesor dhe perqatitja akademike e tyre ne Europe.

Direktiva 97/43/EURATOM e Komisionit European e dates 30 Qershor 1997, ne mbrojtjen e shendetit te individuve ndaj rrezikut te shkaktuar nga rrezatimet jonizuese ne lidhje me ekspozimet mjekesore , percakton Fizikanin Mjekesor si ekspert ne fiziken e rrezatimeve ose ne teknologjine e rrezatimit si dhe perqegjes per mbrojtjen e pacienteve ndaj rrezatimeve . Trajnimet dhe aftesite e ketij profesioni per te vepruar ne kete fushe kryhen nga nje autoritet kompetent i posacem i vendeve europiane. Fifizikani Mjekesor kryen apo keshillon mbi problemet e dozimetriske klinike te pacientit per , zhvillimin dhe perdonimin e teknikave komplekse te trajtimit si dhe problemet dozimetrike te ketyre teknikave, optimizimin e tyre , sigurine e cilesise duke perfshire dhe kontrollin e cilesise. Fizikani mjekesor ka gjithashtu perqegjesi per problemet e mbrojtjes nga rrezatimet te cilat I perkasin ekspozimeve me qellim radioterapie ose radiodiagnostike

Bazuar ne kete directive, (duke iu permajtur shume pikave te tjera te kesaj direktive, jo vetem perkufizimit te dhene ne te), shumica e vendeve te Europes perendimore, kane bere perpjekje dhe vendllojne ligje te cilat regullojnë statusin e Fizikanit mjekesor, duke bere nje nderthurje te perqatitjes akademike me ate te praktikes klinike, mbi te cilen vihet me shume theksi.

Nga eksperienta ne Itali, Spanje, Fizikani Mjekesor eshte nje person i diplomuar ne Fizike, i cili ka kryer nje provim pranimi dhe me pas kryen nje praktike prej 3 vjetesh nen tutorimin e nje supervizori i cili mbikqyr specializimin e tij ne klinike, pas te cilit merr titullin Fizikan Mjekesor. Faza tranzitore ne keto shtete eshte rregulluar me dekrete perkatese duke emeruar automatikisht si Fizikan Mjekesor te gjithe ata persona qe e kane kryer kete veprimtari perpara dates se dekretit dhe te cilet kane perkatesisht 5 ose 7 vjet vjetersi pune ne keto shtete.

Sipas experiences Zviceriane, fizikani mjekesor eshte nje person I diplomuar ne fizike apo shkence ekuivalente, I cili me pas kryen nje praktike prej 3 vjetesh nen drejtimin e nje supervizori I cili mbikqyr specializimin e tij ne klinike. Ne fund te ketij specializimi kandidati kryen nje provim me shkrim dhe me goje qe vleresohej nga nje komision I vecante. Me pas relacioni I supervizorit, rezultati I provimit, nje CV si dhe kurse te tjera te kryera gjate kesaj kohe, paraqiten ne Komisionin e Certifikimit per t'u licensuar si Fizikan Mjekesor. Element I detyruar eshte kryerja e nje kursi te radiombrojtjes. Licensa riperterihet cdo 5 vjet

3. Rekomandimet IAEA, EFOMP

Ne tabelen e meposhtme jane dhene percaktimet aktuale te Fizikanit Mjekesor nga IAEA dhe EFOMP.

IAEA	
Fizikani Mjekesor	
- Te kete nje diplome Universitare ne Fizike apo shkenca te tjera ekuivalente ne shkencat fizike - te kete kualifikime akademike ne nivel pasuniversitar te pershtateshme ne Fizike Mjekesore -Te kete te pakten dy vjet (me kohe te plete) trajnim praktit te strukturuar ne spital	IAEA thekson se mbajtja e nje Diplome Universitare ne Fizike Mjekesore pa praktiken Spitalore nuk do t'a konsideronte personin si te kualifikuar nga ana klinike.
EFOMP	
- Te kete nje diplome Universitare ne Fizike apo shkenca te tjera ekuivalente ne shkencat fizike - Te kete kualifikime akademike ne nivel pasuniversitar te pershtateshme ne Fizike Mjekesore -Te kete te pakten dy vjet (me kohe te plete) trajnim praktit te strukturuar ne spital	Vetem pas kryerjes se praktikes klinike dy vjecare kandidati mund te punoje ne menyre te pavarur ne klinike dhe duhet te njihet si Fizikan Mjekesor . Njohja duhet te kryhet nga autoritet kombetar .

4. Percaktimi i Statusit te Fizikanit Mjekesor ne Shqiperi

Statusi i Fizikanit Mjekesor

Ne Shqiperi percaktimi i statusit te Fizikanit Mjekesor do te plotesoje nje nga kriteret e Vendosjes se Standarteve te Sigurise ndaj Rezatimit te Komuniteteit European si dhe te IAEA (IAEA safety series No.115), si dhe do te startoje procesin e unifikimit te ketij profesioni ne vendit tone me vendet europiane.

Njohja formale e Statusit te Fizikanit Mjekesor duhet te realizohet me dy faza:

- Faza e pare** si faze tranzitore per fizikanet qe aktualisht jane duke ushtruar kete profesion ne Qendra Spitalore, detyrat dhe perqejgesite e te cileve jane ekuivalente me ato qe percaktojne standartet Europiane.
- Faza e dyte** per Fizikanet Mjekesore te ardhshem qe do te duhet te ndjekin kurikulat qe po perqatiten ne nivel Masteri (sistemi i Bolonjes) dhe trajnimi klinik.

- Faza e pare

Per fizikanet qe jane ne faze tranzitore te fitimit te ketij titulli kushtet e meposhtme duhet plotesuar te ndara ne kushte te pergjithshme dhe ne kushte te vecanta per te tre drejtimet e Fizikanit Mjekesor:

Kushte te pergjithshme:

- Te kete nje diplome Universitare ne Fizike .
- Te kete jo me pak se dy vjet eksperience pune me kohe te plete ne nje Qender Spitalore ne Radioterapi, Mjekesi Nukleare apo Diagnostike.
- Te kete kryer specializim te pakten 6 muaj ne fushen e fizikes ne Shqiperi apo jashte saj.
- Te kete ndjekur te pakten nje kurs mbi radiombrojtjen si dhe kete njojuri te bazes ligjore persa i perket mbrojtjes nga rrezatimi

Fizikanet qe kane me shume se 7 vjet pune ne radioterapi, mjekesi berthamore apo radiodiagnostike e fitojne automatikisht statusin e Fizikanit Mjekesor ne fushen perkatese vetem me plotesimin e kesaj vjetersie.

Kushte te vecanta

ne Radioterapi

- Te kete njojuri mbi Dozimetrine Fizike te aparaturave radioterapeutike, ne teleterapi dhe brakiterapi duke perfshire :komisionimin, kalibrimin, dhe kontrollin e sigurise.
- Te kete mare pjese ne komisionimin e te pakten nje aparature megavoltazhi.
- Te kete njojuri per Sistemin e Planit te Trajtimit (SPT), dhe dozimetrine klinike te pacienteve.

ne Mjekesi Berthamore

- Te kete njojuri ne testet e pranimit, komisionimin dhe sigurine e cilesise se pajisjeve te mjekesise berthamore
- te kete njojuri ne matje te aktivitetit te radionuklideve dhe dozimetri klinike.
- te kete njojuri ne perqatitjen dhe aplikimin e protokolleve te cilesise se pajisjeve te mjekesise nukleare

ne Radiodiagnostike

- Te kete njojuri ne testet e pranimit, komisionimin dhe sigurine e cilesise se pajisjeve radiodiagnostikuese
- Te kete njojuri mbi dozimetrine dhe optimizimin e dozave per patientet.

- Faza e dyte

Per Fizikanet Mjekesore te ardhshem eshte e nevojshme kryerja e studimeve akademike te nivelist Master ne Fizike Mjekesore, si dhe ndjekja e nje programi trajnimi ne klinike.

Pjese e rendesishme e ketij procesi do te ishte vendosja e kriterit te trajnimit ne klinike pas masterit per nje periudhe dy vjecare . Trajnimi duhet te kryhet nen supervizimin e nje Fizikani Mjekesor me eksperience.

Ne parim pas kryerjes se trajnimit, kandidati aplikon prane Komisionit per marrjen e statusit te Fizikanit Mjekesor.

Procedurat per te vendsour autoritetin qe do te njohe, certifikoje apo licensoje Fizikanin Mjekesor dhe Ekspertin ne Fizike Mjekesore mbeten per t'u diskutuar ne bashkepunim me KMR, Ministrine e Shendetesise dhe Ministrine e Arsimit dhe Shkences.

Mbetet gjithashtu per diskutim implementimi i nje programi per trajnimin klinik te Fizikaneve Mjekesor, i cili eshte jashte objektivit te ketij materiali.

Statusi i Ekspertit ne Fiziken Mjekesore

Ne lidhje me marrjen e statusit te Ekspertit ne Fizike Mjekesore, duhet qe Fizikani Mjekesor te kete te pakten 5 vjet pune te vazhduar ne kete fushe. Ai duhet gjithashtu qe te kete kryer kurse te rritjes profesionale; nepermjet trajnimesh dhe specializimesh te vazhdueshme ne fushen perkatese.